



Datë: 31.07.2025

Numër Protokolli: 5191/2025

A.nr.1125/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1125/2025 të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesja L.M kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1125/2025, e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesja L.M.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, L.M (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 11.06.2025 ka parashtruar ankesë në e-mailin ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e cila është regjistruar më datë 12.06.2025 dhe me numër protokolli 3959/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00016811, për pozitën e punës “*Zyrtar për Shërbime me Qytetar*”, i shpallur me datë 21.02.2025, nga Komuna e Malishevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës, ndërsa kjo e fundit, më datë 07.07.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesja, **është e pasafatshme, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Malishevës, më datë 21.02.2025 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016811, për pozitën e punës “*Zyrtar për Shërbime me Qytetar*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.02.2025 deri më 23.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëzet e tre (23) kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret i kanë plotësuar dhe kanë vazhduar me fazat e vlerësimit profesional pesëmbëdhjetë (15) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja e cila i është nënshtruar vlerësimit të testit me shkrim, ku ka arritur gjithsejtë 35.6 pikë, të pa mjaftueshme për të vazhduar në fazën e vlerësimit të intervistës me gojë.

Organi përkatës i punësimit, me datë 05.05.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 01/534 lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja M.M, me gjithsejtë 84 pikë të arritura (63 nga testi me shkrim dhe 21 nga intervista me gojë), është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime me Qytetar* pranë Komunës së Malishevës.

Ankuesja, kundër procedurës përkatëse të rekrutimit me datë 11.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave materiale dhe zbatimit të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të aplikueshme, për rezultatin e testit me shkrim, andaj e njëjta kërkon anulimin e konkursit përkatës dhe ri shpalljen e konkursit me mbikëqyrjen nga një Komision tjetër.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja, është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, rezultati përfundimtar është publikuar me datë 05.05.2025, ndërsa ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2025, nga rrjedh se ankesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit **127 paragrafi 1** të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën me numër A.nr.1125/2025 të datës 28.07.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1125/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.M;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.